

Marrja e shtetësisë italiane

Ç'do të thotë kjo

Shtetësia është një status ligjor personal e cila të lejon njohjen si qytetar i një shteti të caktuar. Si pasojë e saj, shtetasi i ri do të përfitojë si të drejta dhe liritë themelore gjithashtu dhe detyrimet e ndërsjellta, sipas statusit të ri ligjor.

Cilat janë rastet kur mund merret shtetësia italiane

Shtetësia Italiane merret në këto raste:

-lindjeje "jure sanguinis" kushdo që lind kudo në botë, duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi italiane, e fiton vetiu shtetësinë italiane;

-lindjeje në territorin italian "jure soli" fiton shtetësinë italiane në rast se është lindur nga prindër të panjohur dhe si pasojë, do të mbetet pa shtetësi; ose kur prindërit janë të huaj dhe nuk i japin fëmijës asnjë shtetësi siç është e parashikuar nga ligji i shtetit përkatës të prindërve; ose kur fëmija është gjendur i braktisur në territorin e shtetit italian;

-njohjeje të atësisë apo mëmësisë nga ana e një qytetari italian ose në rast se prindërit e fëmijës bëhen të njohur **ligjërisht pas një vendimi gjyqësor;**

-birësimi i një të mituri, nëse birësuesi ka shtetësinë italiane.

Shtetësia italiane mund të rifitohet

Personat që, duke u shpërngulur jashtë territorit italian, kanë humbur shtetësinë italiane për çfarëdo lloj shkak, mund ta rifitojnë atë në momentin kur kthehen sërish në Itali.

Shtetësia Italiane mund të merret duke bërë një kërkesë në zyrën e Komunës në këto raste:

1) kur je pasardhës i një stërgjyshi italian (neni 1. Ligji 5 shkurt 1992, n. 91).

Për më shumë informacione dhe sqarime mbi dokumentacionin e nevojshëm duhet t'i referoheni Qarkores n. K28.1, 8 prillë 1991, e cila edhe sot është e vlefshme.

2) cilido qytetarë i huaj që është i lindur në Itali dhe shpreh vullnetin për ta fituar atë sipas nenit 4 pika 2 e Ligjit 5 shkurt 1992, nr. 91: "cilido qytetarë i huaj që ka lindur në Itali, dhe që ka jetuar ligjërisht pa shpëputje nga territori italian deri sa ka mbushur moshën madhore (18 vjeç), bëhet shtetas italian nëse shpreh vullnetin që ta fitojë atë brenda një viti nga data e mbushjes së moshës madhore".

3) të miturit e qytetarëve që marrin ose rifitojnë shtetësinë italiane (neni 14 i Ligjit 5 shkurt 1992, nr. 91: "fëmijët e mitur e qytetarëve që marrin apo rifitojnë shtetësinë italiane, nëse bashkëjetojnë me të marrin shtetësinë italiane. Në momentin kur mbushin moshën madhore mund të aplikojnë për heqje dorë prej saj por vetëm nëse tregojnë që kanë një shtetësi tjetër".

Shtetësia Italiane mund të merret duke bërë një kërkesë në Prefekturën e Firences në këto raste:

- marrje shtetësie për martesë me shtetas italian (matrimonio) (neni 5. Ligji 5 shkurt 1992, nr.91)
- marrje shtetësie për jetesë me kohë të gjatë dhe pashaportizim në Itali (residenza) (neni 9 i Ligjit 5 shkurt 1992, nr. 91).

Shtetësia Italiane merret gjithashtu dhe në bazë të Ligjeve të veçanta në rastet kur:

- janë pasardhës të qytetarëve të ish perandorisë Austro-Hungarezë;
- janë pasardhës të qytetarëve që jetojnë dhe janë me pashaportizim (residenze) në territorin e Trieste-s që pas Luftës së Dytë Botërore;
- janë pasardhës të qytetarëve që ndodhen në vende që kanë qënë italiane dhe që i janë dhënë ish Jugosllavisë pas Luftës së Dytë Botërore .

Betimi

Brenda gjashtë muajve nga data e marrjes së Dekretit për marrjen e shtetësisë duhet të bëhet betimi sipas nenit 10 i Ligjit 91/1992. Për të kërkuar që betimi të bëhet përpara Kryetarit të Komunës apo një të deleguari të tij, duhet lënë para një takim me Zyrën e Gjendjes Civile (Ufficio di Stato Civile).

Aktet Ligjore dhe nënligjore

Ligji 98/2013 (neni 33) dhe sipas ndryshime të dekretit ligjor datë 21 qershor 2013, nr.69. Dispozita urgjente për rinisje të ekonomisë D.P.R 396/2000 - Rregullore për rishikim dhe thjeshtëzim të organizimit të Gjendjes Civile sipas nenit 2, pika 12. Ligji 127/1997 - Thjeshtëzim mbi rregullat e dokumentacionit administrativ D.P.R 572/1993 - Rregullore për zbatimin e Ligjit 5 shkurt 1992, nr.91, për rregulla të reja mbi shtetësinë. Ligji 91/1992 Rregulla të reja mbi Shtetësinë - Ligji 555/1912, Ligji 13 qershor 1912, nr. 555 mbi shtetësinë italiane. Ligji 151/75 Reforma për të drejtën familiare.

Faqe interneti të tjera

[Prefettura di Firenze](#)

Sa kushton

Duke nisur nga data 05/10/2018, sipas nenit 14 të D.L 4 tetor 2018 nr. 113, kontributi për çdo praktikë në fjalë si për zgjedhje, marrje, rifitim, heqje dorë, apo dhënie shtetësie italiane është në shifra 250,00 euro. Për më shumë informacione lexo vendimin dhe shiko si shembull këtë mandatpagese (bolletino)

[Vedi Circolare](#)

[Bollettino](#)

Njohja e gjuhës italiane

Dekreti Ligjislativ i datës 04 tetor 2018 nr. 113 ka vendosur që për marrjen e shtetësisë si për martesë (neni 5) dhe për pashaportizim me afat të gjatë (residenza) (neni 9) të interesuarit duhet të kenë një njohje të mirë të gjuhës italiane jo më pak se niveli B1 të përcaktuar sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian i Referencës për gjuhët e huaja (QCER).